



**Republika e Kosovës – Republika Kosova**  
**Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashitresa**  
**Izborni Panel za Žalbe i Predstavke**

**ZL.Anr.873/2017**

**Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashitresa (PZAP)**, në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Zyhdi Haziri kryesues, Ymer Hoxha dhe Afijete Sada Gllagjani anëtar, me pjesëmarrjen e Zyrtares Ligjore Arjeta Sylja, duke vendosur përkitazi me apelin e parashtruar nga Berat Lahu, kandidat për anëtar të Kuvendit Komunal në Prishtinë, nga radhët e subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), me seli në Prishtinë, paraqitur kundër vendimit Nr.2232-2017 të datës 08.11.2017, të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ) për shpalljen e rezultateve përfundimtare për Kuvendet Komunale, për Zgjedhjet Lokale të mbajtura më datë 22.10.2017, në seancën e panelit të mbajtur më datë 12.11.2017, mori këtë:

## **V E N D I M**

**I. PRANOHET** si i bazuar apeli i Berat Lahu, kandidat për anëtar të Kuvendit Komunal në Prishtinë, nga radhët e subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), me seli në Prishtinë.

**II. Urdhërohet** Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ) që të rinumëroj fletëvotimet për kandidatët për anëtar të Kuvendit Komunal në Prishtinë, nga radhët e subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), me seli në Prishtinë, në Vendvotimet nr. 1901E/01R, 1904E/11R, 1904E/12R, 1909E/03R, 1906E/07R, 1912E/01R, 1913E/04R, 1914E/01R, 1917E/01R, 1917E/04R, 1917E/07D, 1918E/02R, 1919E/06R, 1919E/07D, 1921E/01R, 1927E/07R, 1927E/08R, 1931E/02R, 1931E/03R, 1940E/02R, 1940E/03R, 1959E/01R, Prishtinë.

**III. Rezultati** i cili del pas rinumërimit të fletëvotimeve në kutit e Vendvotimeve si në pikën -II- të këtij dispozitivi, të përfshihen në rezultatin përfundimtar.

## **A r s y e t i m**

PZAP-i, ka pranuar një apel me datë 10.11.2017, nga Berat Lahu, kandidat për anëtar të Kuvendit Komunal në Prishtinë, nga radhët e subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), me seli në Prishtinë, me të cilën ka pretenduar se në vendvotimet: 1901E/01R, duhet të ketë 4 vota, 1904E/11R duhet të ketë 4 vota, 1904E/12 duhet të ketë 1 votë, 1906E/07R duhet të ketë 2 vota, 1909E/03R duhet të ketë 4 vota, 1906E/07 duhet të ketë 2 vota, 1912E/01R duhet të ketë 1 vota, 1913E/04 duhet të ketë 6 vota, 1914E/01 duhet të ketë 3 vota, 1917E/01R duhet të ketë 4 vota, 1917E/04R duhet të ketë 10 vota, 1917E/07D duhet të ketë 7 vota, 1918E/02R duhet të ketë 5 vota, 1919E/06R duhet të ketë 10 vota, 1919E/07 duhet të ketë 8 vota, 1921E/01R duhet të ketë 6 vota, 1927E/07R duhet të ketë 10 vota, 1927E/08R duhet të ketë 10 vota, 1931E/02R duhet të ketë 5 vota, 1931E/03R duhet të ketë 9 vota, 1940E/02R duhet të ketë 10 vota, 1940E/03R duhet të ketë 10 vota, 1959E/01R duhet të ketë 4 vota dhe këto vendvotime ka kërkuar që të rinumërohen për arsye se dyshon se votat e tij i janë bartur kandidatëve të tjerë.

PZAP-i, pas shqyrtimit të bazueshmeris se apelit vlerësimit të shkresve të lëndës, në kuptim të nenit 117 paragrafi 2 dhe 3 të LZP-së, gjeti se:

### **Apeli është i bazuar**

Paneli gjeti se pretendimet ankimore janë të bazuara, pasi që pas shqyrtimit të shkresave të lëndës, ka vlerësuar se ka mospërputhje të rezultateve të shpallura nga KQZ-ja me Formularët e Rezultateve të Kandidatëve dhe Formularit Përfundimtar të Rezultatit, andaj mbi këtë bazë dhe në mbështetje të nenit 117.4 të LZP-së, PZAP-i urdhëron KQZ-në, që të bëhet rinumërimi i të gjitha fletëvotimeve për kandidatët nga radhët e subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV) vendvotimet e cekura në pikën II të dispozitivit të vendimit dhe rezultati i dalur nga rinumërimi të përfshihet në rezultatin përfundimtar të Zgjedhjeve Lokale të datës 22.10. 2017.

Prandaj, më qëllim të evitimit të këtyre lëshimeve të lartë cekura miratoj apelin si të bazuar në mbështetje të nenit 115.1, dhe nenin 119.5 të LZP-së, ku parashihet se, *PZAP-i mundet që sipas vendimit të tij të shqyrtoj çështje të cilat përndryshe janë nën juridiksionin e tij kur kjo është rreptësisht e domosdoshme për të parandaluar padrejtësi serioze.*

Nga sa u tha më sipër duke u bazuar në nenin 118 paragrafi 1 të LZP-së, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

**Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa**  
ZL.A.nr.873/2017 me datë 12.11.2017



**Këshillë Juridike:** Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa.